

VIBIA SH.P.K.

TIRANË- SHQIPËRI

AKT THEMELIMI

Sot, më 20.02.2020, palët si më poshtë:

- **Z. Elvis Sula**, shtetas shqiptar, lindur më 29.09.1977 në Tiranë, Shqipëri, banues në Rr. "Ded Gjo Luli", Nr. 8, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033091930 dhe nr.personal H70929121H;
- **Znj. Xheni Sula**, shtetase shqiptare, lindur më 04.01.1983 në Tiranë, Shqipëri, banuese në Rr. "Ded Gjo Luli", Nr. 8, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.032245245; dhe
- **S&D Invest Sh.a**, një shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi (NUIS) K82112004C dhe me adresë të regjistruar në Farkë, Rezidencia Kodra e Diellit, Selitë, Tiranë, Shqipëri.

(referuar më poshtë si "**Themeluesi**" ose "**Themeluesit**" ose "**Ortaku**" ose "**Ortakët**") me vullnetin e tyre të lirë deklarojnë themelimin e shoqërisë dhe bien dakord mbi këtë Akt Themelimi, si vijon:

KAPITULLI I: Emri, Forma Ligjore, Selia e Regjistruar, Kohëzgjatja

Neni 1. | Emri i Shoqërisë

1.1 Shoqëria ka emrin Vibia Sh.p.k. ("**Shoqëria**"). Shoqëria ka emërtimet tregtare Sun Wellness, Sun Fit, Piazza di Pietra. Në të gjithë dokumentet, faturat dhe publikimet e Shoqërisë, emri i saj do të ndiqet nga:

(a) fjalët "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" apo "Sh.p.k."

Neni 2. | Forma Ligjore e Shoqërisë

2.1. Vibia Sh.p.k është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar e organizuar në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me ndryshime ("**Ligji Tregtar**") dhe me dispozitat e këtij Akti Themelimi ("**Akti i Themelimit**"), Statutit ("**Statuti**") dhe çdo ndryshim të tyre.

Neni 3. | Selia e regjistruar e Shoqërisë

3.1. Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: Rezidencia "Kodra e Diellit 2" Tiranë, Shqipëri. Shoqëria ka të drejtë të transferojë selinë e saj në një adresë tjeter në Shqipëri.

Neni 4. | Kohëzgjatja e Shoqërisë


4.1. Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

KAPITULLI II: Objekti i aktivitetit të Shoqërisë

Neni 5. | Objekti i aktivitetit të Shoqërisë

5.1. Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është si vijon:

- Palestër
- Fitness
- Kurse noti
- Shërbime e trajtime estetike e relaksi
- SPA, Wellness
- Bar, restorant



5.2 Në përputhje me legjislacionin Shqiptar për përbushjen e objektit të sipërmendur, Shoqëria mund:

- (i) të aplikojë pér pajisjen dhe tē pajiset me tē gjithë licencat dhe lejet e duhura pér kryerjen e çdo aktiviteti përfshirë edhe me pasuri të luajtshme dhe tē paluajtshme si edhe aktivitete tregtare, financiare, qira, hipotekore apo krijimin e barrëve tē cilat mund tē konsiderohen tē dobishme apo tē nevojshme pér përbushjen e objektit të Shoqërisë dhe qe nuk tejkalojnë nē masë aktivitetet kryesore, tē cituara me sipër;
- (ii) tē blejë, nē mënyrë tē drejtpërdrejtë apo tē tērthortë, interesa nē shoqëri tē tjera qē kanë objekt (objekti i aktivitetit) tē ngashëm me atë tē Shoqërisë, nē Shqipëri apo jashtë saj; dhe
- (iii) tē kryejë aktivitete publikimi, marketingu e reklamimi;
- (iv) tē kryejë aktivitete import—eksporti tē mallrave dhe/apo shërbimeve siç do tē konsiderohet e nevojshme;
- (v) tē kryejë aktivitete pér shitjen me pakicë apo shumicë tē mallrave, pajisjeve siç do tē konsiderohet e përshtatshme;
- (vi) tē kryejë çdo aktivitet tjetër që mund tē konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm pér përbushjen e objektit të Shoqërisë.

5.3 Shoqëria do tē kryejë çdo aktivitet që përfshihet nē objektin e saj tē aktivitetit.

5.4 Shoqëria do tē respektojë tē gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse nē Republikën e Shqipërisë dhe standartet më tē mira etike.

Neni 6 | Ndryshimi

6.1. Shoqëria ka tē drejtë tē ndryshojë objektin e aktivitetit tē saj nē çdo kohë siç parashikohet nē këtë Akt Themelimi dhe nē Statutin e saj.

Neni 7 | Statuti

7.1 Palët deklarojnë se bien dakord pér pajisjen e Shoqërisë me Statut, tē nënshkruar rregullisht nga Palët.

KAPITULLI III: Kapitali i Regjistruar

Neni 8 | Kapitali i regjistruar i Shoqërisë dhe Ortakët

8.1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 100 Lekë (njëqind Lekë Shqiptare), i ndarë nē tre (3) kuota.

Ortakët e Shoqërisë dhe kuotat përkatëse tē tyre janë si më poshtë:

- **Z. Elvis Sula**, shtetas shqiptar, lindur më 29.09.1977 nē Tiranë, Shqipëri, banues nē Rr. "Ded Gjo Luli", Nr. 8, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033091930 dhe nr.personal H70929121H, i cili do tē zotërojë 1 (një) kuotë tē barabartë me Lekë 45 (dyzet e pesë Lekë Shqiptare) që përfaqëson 45 % (dyzet e pesë përqind) tē kapitalit tē Shoqërisë;
- **Znj. Xheni Sula**, shtetase shqiptare, lindur më 04.01.1983 nē Tiranë, Shqipëri, banuese nē Rr. "Ded Gjo Luli", Nr. 8, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.032245245 e cila do tē zotërojë 1 (një) kuotë tē barabartë me Lekë 45 (dyzet e pesë Lekë Shqiptare) që përfaqëson 45 % (dyzet e pesë përqind) tē kapitalit tē Shoqërisë, dhe
- **S&D Invest Sh.a**, një shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjeve tē Republikës së

Shqipërisë e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi (NUIS) K82112004C dhe me adresë të regjistruar në Farkë, Rezidenca Kodra e Diellit, Selitë, Tiranë, Shqipëri e cila do të zoterojë 1 (një) kuotë të barabartë me Lekë 10 (dhjetë Lekë Shqiptare) që përfaqëson 10 % (dhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë (secili si "Ortaku" dhe bashkërisht si "Ortakët").

Neni 9. | Të drejtat dhe Detyrimet e Ortakëve

- 9.1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë zoterohet tërësisht nga Ortakët e shoqërisë.
- 9.2. Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë përbëhet nga Ortakët e Shoqërisë që kanë të drejtën e një vote në Asamblenë e Përgjithshme që së bashku përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë dhe që i jep të drejtën Ortakëve të Shoqërisë të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet qeverisëse vendimmarrëse të shoqërisë, të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë (sipas dispozitiveve të këtij Akti Themelimi, Statutit dhe atyre ligjore) si edhe të gjithë të drejtat e tjera që parashikohen në këtë Statut.
- 9.3. Ortakëve të Shoqërisë do t'i jepet nga menaxhmenti i Shoqërisë në çdo kohë pa kërkesë me shkrim, i gjithë informacioni dhe të dhëna lidhur me aktivitetin e Shoqërisë, përfshire të drejtën e kontrollit të librave dhe të dokumenteve të Shoqërisë.
- 9.4. Detyrimet e Shoqërisë garantohen nëpërmjet kapitalit të saj dhe Ortakët e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi vetëm deri në vlerën e pjesëmarrjes së tyre në kapitalin e Shoqërisë; Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi përtjerë vlerës së pjesëmarrjes së tyre në kapitalin e Shoqërisë (më përashtim të rastit të dorëzanisë për garantimin e huave apo të detyrimeve të tjera të Shoqërisë).
- 9.5. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe apo detyrimet personale të Ortakëve të saj.

KAPITULLI IV: Asambleja e Përgjithshme

Neni 10. | Kompetencat dhe Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme

- 10.1. Asambleja e Përgjithshme që përbëhet nga të gjithë Ortakët e saj është organi më i lartë vendimmarrës dhe i kontrollit të Shoqërisë e cila merr vendime në lidhje me aktivitetin e saj dhe politikat ekonomike dhe tregtarë të saj.
- 10.2. Asambleja e Përgjithshme ka kompetencat e mëposhtme të cilat i përkasin ekskluzivisht Asamblesë së Përgjithshme dhe nuk mund të delegohen:
 - (a) Miratimi i ndryshimit dhe/apo amendimit te Statutit;
 - (b) Miratimi i zmadhimit dhe/apo zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë;
 - (c) Miratimi i shpërndarjes së fitimeve vjetore;
 - (d) Miratimi i riorganizimit të Shoqërisë dhe prishja apo likuidimi saj;
 - (e) Miratimi i emërimit dhe i shkarkimit në çdo kohë të Administratorit (vë) të Shoqërisë;
 - (f) Miratimi i udhëzimeve bazike për kryerjen e aktivitetit tregtar të Shoqërisë;
 - (g) Miratimi i raporteve vjetore, bilancit, pasqyrave të fitim dhe humbjeve, raporteve të auditimit, bilancit dhe likuiditeteve si edhe çdo forme tjetër të pasqyrave financiare të Shoqërisë;
 - (h) Miratimi i mbulimit të humbjeve;
 - (i) Miratimi i rezervës ligjore apo vullnetare të Shoqërisë;
 - (j) Miratimi i themelimit të degëve, filialeve dhe të selive sekondare të Shoqërisë dhe i pjesëmarrjes në shoqëri të tjera;
 - (k) Miratimi i huave të Shoqërisë me përashtim të transaksioneve kredituese gjatë ushtrimit normal të aktiviteti tregtar të Shoqërisë;

- (l) Miratimi i shpërblimit dhe/apo kompensimit të Administratorit (ve);
- (m) Miratimi i kryerjes së aktiviteteve të tjera të reja tregtare dhe/apo transaksioneve të reja;
- (n) Miratimi i krijimit të një hipoteke, pengu apo i garancive të ngjashme;
- (o) Miratimi i blerjes së pasurive të paluajtshme;
- (p) Miratimi i blerjes të pjesëmarjeve apo kuotave të kapitalit të një subjekti tjetër;
- (q) Çdo çështje tjetër që përcaktohet nga ligji i zbatueshëm.

KAPITULLI V: Administratori

Neni 11. | Administratori

11.1. Shoqëria përfaqësohet dhe menaxhohet nga 1 (një) Administrator i cili është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për aktivitetin e zakonshëm të tregtar të Shoqërisë me përjashtim të atyre çështjeve që parashikohen në këtë Statut dhe nga ligji i zbatueshëm apo vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, herë pas here.

11.2. Administratori i Shoqërisë është:

Znj. **Xheni Sula**, shtetase shqiptare, lindur më 04.01.1983 në Tiranë, Shqipëri, banuese në Rr. "Ded Gjo Luli", Nr. 8, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.032245245 dhe nr. personal I351040380 me kompetenca për të përfaqësuar Shoqërinë me të drejtë nënshkrimi të vetëm ("Administrator").

11.3. Administratori emërohet për një afat në detyrë prej 3 (tre) vitesh nga data e regjistrimit të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Shqipëri ("QKB") me të drejtë ripërtëritje.

11.4. Kompetencat e Administratorit që përfaqëson Shoqërinë përfshijnë:

- a) T'i propozojë Asamblesë së Përgjithshme për miratim çdo vendim lidhur me çështjet në kompetence të Asamblesë së Përgjithshme;
- b) Të menaxhojë aktivitetin e Shoqërisë duke zbatuar politikat dhe planet e vendosura nga Ortaku i Vetëm;
- c) Të përfaqësoje Shoqërinë përkundrejt palëve të treta;
- d) Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- e) Të përgatisë dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor dhe bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për t'ia paraqitur Asamblesë së Përgjithshme për shpërndarjen e fitimeve;
- f) Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- g) Të kryejë regjistrimet e detyrueshme të të dhënavë të Shoqërisë, pranë QKB siç do të kërkohet;
- h) Të raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe, kryerjen e transaksioneve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
- i) Të kryejë detyra të tjera sipas udhëzimeve të Asamblesë së Përgjithshme apo të përcaktuara në ligj, herë pas here;

KAPITULLI VII: Të ndryshme

Neni 12. | Gjuha

12.1 Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje në Shqip me vlerë të njëjtë ligjore.


Neni 13. | Dispozitat Përfundimtare

13.1 Çështjet që nuk rregullohen shprehimisht në këtë Akt Themelimi do të rregullohen sipas Statutit, Ligjit Tregtar me ndryshime.

Ky akt themelimi konsiderohet si mbledhja e parë e Asamblessë së Përgjithshme të ortakëve themelues të shoqërisë. Ky Akt Themelimi është hartuar sipas Ligjit Tregtar, i ndryshuar.


ORTAKËT THEMELUES

Z. Elvis Sula



S&D Invest Sh.a
Administrator

Znj. Xheni Sula



Znj. Enkelejda Metohu

